

BASHKIA KOLONJË
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Autoriteti: Bashkia Kolonjë
Adresa Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax +355 812 23173 ; 08122225 ; 2232
E-mail bashkia.kolonje@gmail.com
Faqja e Internetit <http://www.kolonja.gov.al>
2. Dhënie me qira, me konkurim publik, të tokës në pronësi të Bashkisë Kolonjë për Njësinë Administrative Qendër Ersekë, me nr.pasurie 685, Zona Kadastrale 3510, Fshati Starje, Rrethi Kolonjë.
3. Qëllimi i dhënies me qira të pasurisë nr.685, Zona Kadastrale 3510, Fshati Starje, Rrethi Kolonjë është dhënia në përdorim për zhvillim ekonomik, në fushën e energjive të rinovueshme, etj.
4. Konkurrimi do të zhvillohet më datë:14.12.2020, ora 11:00, në Zyra e Këshillit Bashkiak, Bashkia Kolonjë.
5. Çmimi dysHEME i qirasë, është 27,000 (njëzeteshtatë mijë) lekë/ha në një vit kalendarik.
6. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë 20 (njëzet) vjet.
7. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar, me dokumentacionin si vijon :
 - a) Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit të parashikuar sipas planit të biznesit;
 - b) Planin biznesin e hollësishëm ku të përshkruhen qartë ;
 - identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen,
 - përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit
 - analiza e detajuar e afatit kohor, që do të duhet për të realizuar projektin investues dhe treguesit që do të realizohen brenda një periudhe jo më të gjatë se 1/4 e afatit të kontratës të cilët duhet të ruhen, deri në fund të afatit të kontratës si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij
 - niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.
 - c) Çertifikatën e regjistrimit dhe Çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKB
 - d) Vetëdeklarim për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit ofertues
 - e) Vetëdeklarim mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore
 - f) Vetëdeklarim se subjekti ofertues dhe administratori nuk është në ndjekje penale dhe nuk ka proces/e gjyqësor/e që lidhet/n me aktivitetin.
 - g) Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore të Bashkisë Kolonjë, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të

- kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore të kësaj bashkie.
- h) Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2019 dhe për vitin e fundit 2020 (këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron/jnë aktivitetin.
 - i) Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në cdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues
 - j) Dokument nga OST/OSHEE, i cili vërteton që ofertuesi disponon miratimin paraprak për pikën e lidhjes me rrjetin e energjisë elektrike nëse projekti i propozuar përfshihet në fushën e prodhimit të energjisë elektrike.
 - k) Afatin e përdorimit të tokës objekt qiramarrje.
8. Ofertat paraqiten në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit, fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Kolonjë, para orarit të hapjes së ofertave.
9. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:
- a) Niveli i Investimit 25 pikë
 - b) Niveli i Punësimit 25 pikë
 - c) Oferta e Detyrimit Mijor të Qirasë 15 pikë
 - d) Kontributi financiar i ofertuesit në përmirësimin e infrastrukturës lumore për mbrojtjen e zones nga përmbytjet e përroit të Varibobit 15 pikë
 - e) Eksperiencë në vite e ofertuesit në fushën e aktivitetit që ofrohet të zhvillohet sipas planit të biznesit. 20 pikë
- ***Sqarim: Pasuria nr.685, zona kadastrale 3510, fshati Starje, Rrethi Kolonjë është përmbytur vazhdimisht nga përroi i Varibobit (Starjes). Për zhvillimin e aktivitetit në këtë pasuri, ofertuesi duhet të planifikojë mbrojtjen nga përmbytjet të aktivitetit që do të zhvillohet sipas planit të biznesit. Kjo mbrojtje lumore gjithashtu do të jetë në interesin publik të komunitetit të zonës.
10. Subjektet e interesuara për qiramarrje ose përfaqësuesit e tyre të pajisur me procure origjinale/fotokopje të noterizuar dhe dokument identifikimi mund të tërheqin dokumentat e konkurimit Brenda 4 (katër) diteve nga data e shpalljes të këtij njoftimi, nga ora 10:00-14:00, pranë Zyrës së Financës në Bashkinë Kolonjë kundrejt tarifës 1000 (njëmijë) lekë. Konkurruesit të cilët nuk kanë tërhequr dokumentat nuk mund të marrin pjesë në procedurën konkurruese.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
NJOFTIM PËR MARRJEN ME QIRA TË PASURISË NGA TË TRETËT
PËR USHTRIM AKTIVITETI DOGANOR NGA DEGA DOGANORE SARANDË

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton të interesuarit/konkurrentët se kërkon të marrë me qira godinë/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë doganore të Degës së Doganës Sarandë, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme: